



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 08/2011
Prishtinë, më 03.05.2011, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostić.

Munguan: Berat Buzhala dhe Hashim Deshishku.

Të ftuarit për raportim: Dino Asanaj, kryetari i bordit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit Shkelzen Lluka, drejtor menagjues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Gashi- USAID, Besnik Ramadanaj – KDI, Ukë Gashi – ZPRK dhe Lejla Selmi OSCE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.04.2011;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2010;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës; 26.04.2011

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 26.04.2011, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2010

Kryetari – theksoj se siç është paraparë për këtë pikë të rendit të ditës, ku do të shqyrtohet Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2010, kemi ftuar kryetarin e Bordit z.Asanaj, i cili do të paraqet një ekspozë të shkurtë për këtë Raport.

Dino Asanaj (kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të privatizimit-AKP) – theksoj se deri me tani AKP-ja ka realizuar shitje në vlerë mbi 500 milion euro, dhe me likuidim mbi 40 milion euro; 75% të mjeteve të listes së 20% është shpërndarë; zakonisht është njoftu Kuvendi përmes raporteve 3 mujore për aktivitetet e AKP-së; biznesplan i hartuar është përmbush në pëkipëmeri; AKP është duke punuar rreth TREPÇË-s për identifikimin e kreditorve të mundshëm; njoftoi Komisionin se do të ndryshoj sistemi i likuidimit që ka ekzistuar ose që ka punuar Agjencia më të; në fund tha se sfida paraqet ende Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për të cilën njoftoi se në Qeveri është duke u hartuar Projektligji për këtë çështje dhe AKP do të jap kontributin e saj sa here që ti kërkohet nga Kuvendi.

Kryetari - pyeti se me krijimin e ndërmarrjeve të reja që keni përmendur edhe në raport, çka është synimi i AKP-së në lidhje me themelimin e këyre ndërmarrjeve?

Shkelzen Lluka (Drejtor menaxhues i AKP-së) - prej një ndërmarrje shoqërore në mund të ndërtojmë disa ndërmarrje të reja të cilat i vejmë në treg në mënyrë që të jenë sa më atraktive për investitorët e mundshëm. D.m.th kur ne e ndërtojmë një ndërmarrje të re, një ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar. Në ndërmarrjen e re ne i transferojmë vetëm disa obligime kurse të pjesa e tjetër e obligimeve të ndërmarrjes shoqërore mbetet që të procedohet gjatë procesit të likuidimit.

Kryetari - pyeti se pse nuk pritet Lista përfundimtare e punëtorëve të 20% e mandej me u shpërndarë 20% i mjeteve për të gjithë punëtorët?

Shkelzen Lluka (Drejtor menaxhues i AKP-së) - Agjencioni e ka marrë një veprim ku ka përpiluar Strategjinë për shpërndarjen e përkohshme të 20%-it, kjo është bërë e mundur që të kemi aq sa mundemi një paqe sociale me punëtorë pasi që bëhet shpërndarje deri në 75% e 20%-it varësisht nga kërkesat që ka në Odën e Veçantë. Në sigurohemi që mos të tejkalojmë shumën e cila është paraparë për shpërndarjen të mjeteve të punëtorëve dhe pas vendimit të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, e mandej e bëjmë edhe shpërndarjen përfundimtare. Kjo është bërë edhe për arsye të periudhës tri vjeçare të ekzistimit pas pavarësisë së Kosovës, ku Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme deri më tani ka mbaruar vetëm dy lista përfundimtare, nga i tërë numri që ne kemi bërë shpërndarje dhe të gjitha listat të cilat I kemi pranuar nga ndërmarrjet shoqërore vetëm dy lista janë aprovuar nga Oda e veçantë e Gjykatës Supreme do të thotë po të

mos ishte aprovuar Strategjia nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së, ne deri më tani do ti shpërndanim vetëm këto dy lista.

Myzejene Selmani - ne i kemi përcjellur edhe raportet e juaja të mëhershme në Kuvend, duke e marrur parasysh strukturën e raportit mua më duket se është më i shkurtër se raportet e tjera, kjo në shikim të parë duket kështu. Mirëpo i gjithë materiali i cili është prezent këtu në këtë materialin e juaj, shuma totale nga privatizimi gjatë vitit të kaluar ka qenë një debat i nxehtë mes jush dhe zyrës së ICO-së, në lidhje me çështjen e kthimit të parave të privatizimit. Dhe duke e marrë parasysh se ligji i cili është miratua në atë kohë me Pakon e Ahtisarit, ka qenë ligj i Pakos dhe shpresoj që shumë shpejtë do të amendamentohet edhe në të mirë që Agjencioni Kosovar i Privatizimit ti ketë kompetencat ashtu si duhet, ti ketë dhe kërkesat e juaja. Në tri raportet e para që i keni sjellë në Kuvend të Kosovës, kanë qenë shumë të qarta, mirëpo kanë hasur në vesh të shurdhët është problemi i Odës, të cilën e cekët edhe ju pak më parë dhe tash po shihet se ai problem tash është problem i Trepçës si tërësi, dhe kemi problem edhe shumë të ndërmarrjeve tjera që potencuat më parë, se kemi problem lidhur me çështjen e likuiditetit të ndërmarrjeve, kemi çështje këtu në raport në faqen 15-të mos gabohem, është çështja e Spinofit Special dhe pyes z.Dino, se çka po ndodh me këto Spinofe Speciale? Të cilat i keni në vazhdimësi në monitorim edhe njësitë e Trepçës, ku ju e potencuat pak më parë se në Strategjinë e Komisionit e kemi çështjen e ligjeve, të cilat do zoti dhe të miratohen sa më shpejtë dhe të del nga kjo gjendje ndërmarrja e Trepçës. Atëherë në mënyrë më të qartë kisha kërkuar përgjigje prej jush. Edhe cila është politika në të cilën mundeni me arrit me Qeverinë e Kosovës me stafin e ICO-së në lidhje me kthimin e të hyrave nga privatizimi në Kosovë?

Teuta Sahatqia – theksoj se prej faqes 21 janë ndërmarrjet që janë nën administrimin e drejtpërdrejt, pyeti se cilat janë pengesat? Pse qëndrojnë ato ndërmarrje nën administrim? Cilat veprime do të ndërmerren? Gjithashtu, pyeti edhe për fatin e shoqërive aksionare në Gjakovë? Cilat janë ato procedura të cilat duhet ti nxjerrin këto ndërmarrje dhe të vazhdojnë të privatizohen?

Ramiz Kelmendi – theksoj se që një kohë të gjatë mjetet e privatizimit janë duke qëndruar jashtë vendit, ku për shkak së legjislacionit joadekuat ato mjete nuk po kthehen. A mundet Bordi i AKP-së me sjellë një vendim që këto mjete të grumbulluara të kthehen në vend? Siq e ka sjell për 20%-in. Pastaj shtoj se të gjithë ata që blejnë asete a mund me e dorëzua një garancion bankar i cili mund të realizohet mbas një viti ose të jetë si formë kreditore? Në mënyrë që investitori i cili e ka blerë objekt të ketë mundësi ta zhvilloj objektin dhe ti kyqet zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Visar Ymeri – shtroj disa pyetje si: AKP a monitoron kompanite të privatizuara të Spinofeve Speciale, lidhur me zbatueshmërinë ose zbatimit në vazhdimësi të kushteve nga kontratat që dalin nga kontratat Spinofeve Speciale? Sa i përket SHARR CEM-it, në raport thuhet që janë mbajtur të gjithë punëtorët në ndërmarrjen e tanishme, nga sindikata thojnë, ata që kanë bërë protesta edhe para edhe pas sajë thuhet që punëtorët nuk janë mbajtur në punë edhe mënyra se si i trajton blerësi punëtorët është shumë e keqe, kështu që çfarë monitorimi i keni bërë kësaj pune dhe a do ta monitoroni në vazhdimësi punën e punëtorëve nga ndërmarrja? Pse kjo ndërmarrje është shitur pa kurrfar tenderi dhe i është shitur drejtpërsëdrejti komercializuesit? I cili nuk ka qenë komercializuesi origjinal, por që e ka marrë pas disa viteve. Në kontratën fillestare, kontratën origjinale të komercializimit të punës, cekët në mënyrë eksplicite që investimet të cilat do ti bëjë komercializuesi nuk do ti merren parasysh ose nuk do ti hiqen nga çmimi i blerjes, ndërkohë, që këtu po thuhet se të gjitha këto janë marrë parasysh, dhe për këtë arsye pse ndërmarrja është shitur aq lirë? Për shkak të këtyre investimeve të bëra, edhe për investimet e zotuar për të ardhmen.

Lutfi Zharku - theksoj se u cek më herët se është plotësuar Plani i Biznesit, ndërsa në Raportin e juaj ka shënime në veç tërësi, e jo shënime lidhur me detaje, si çështjet e penaleve lidhur me Spinofet Speciale etj. Janë katër ndërmarrje, qe dëgjohen ne media se ato nuk i kanë plotësuar kushtet e kontratës. Është dashur Raporti ta ketë edhe një pasqyrë se sa ndërmarrje kanë me u privatizua dhe cili është afati për privatizimin e tyre nga ana e AKP-së? Për Trepçën, keni shumë pak shënime dhe sa është e arsyeshme Qeveria me e financuar?

Fikrim Damka – pyeti ne lidhje me faqen 41 të Raportit, cilat janë ofruesit e këtyre shërbimeve që janë të raportuara? Sepse është një shumë rreth 800 mijë eurove.

Sala Berisha Shala – theksoj se Raporti është i përpiluar shumë mirë dhe të njëjtin e mbështeti dhe një gjë të tillë kërkoj nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Shtoj më tej se ne Komision do të jenë të gatshëm për bashkëpunim për të shqyrtuar Projektligjin për Dhomën e Veçantë dhe kërkoj nga AKP-ja që të përkushtohen maksimalisht që të shtyje përpara procesin e draftimit të këtij projektligji për të ardhur sa më parë edhe në Kuvend. Është përmend se Trepça dhe AKP-ja, nuk kanë mundësi buxhetore por janë në kërkim të mundësive që të thithin fonde për projektin e mjedisit nga donatorët. Pyeti se cili është bashkëpunimi me institucionet tjera në lidhje me ambientin? sa jeni të kënaqur me këtë bashkëpunim? Cili është bashkëpunimi në mes juve dhe të gjitha dikastereve? Këtu e keni paraqitur edhe si problem që në vitin 2010-të bie fjala te minierat në Staritërg dhe Ajvali në mungesë të licencës, është dëmtuar kompania, diku më shumë se 1 milion euro. Sa janë të gatshëm institucionet tjera që ti sqarojnë ato paqartësitë në lidhje me këto problematika?

Kryetari - pyeti rreth detyrimeve ndaj ambientit te Trepça, çfarë masash ka marr AKP së bashku me institucionet tjera në lidhje me këtë çështje? Cila është ana ligjore e privatizimit të SHARR CEM-it? Gjatë vitit 2010 Bordi ka miratuar shkëputje të kontratave të komercializimit për shkak të shkeljes së kushteve të kontratave, a keni menduar se këto duhet të dalin në privatizim të vazhdojnë prapë në komercializim? A ka ndonjë raport më të saktë rreth tyre? Pastaj te ndëshkimet financiare si pasoj e nivelit të ulët për mbushjen e kushteve për zotimin nga ana e blerësve për Spinof Special, a mendoni se këto ndërmarrje do të ndikojnë pozitivisht për përmbushjen e obligimeve?

Dino Asanaj (kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare te privatizimit-AKP) – dha këto përgjigje për deputetët: ndoshta AKP ka qenë më e zëshme lidhur me mjetet e privatizimit dhe mendoj se mjetet do të kishin qenë një infuzion shumë i mirë për zhvillimin ekonomik për Kosovën, sipas Rregullorës së UNMIK-ut, Bordi nuk ka drejtë në plasimin e mjetëve lidhur me projekte por duhet me ju përmbajt ligjit, dhe në bazë të ligjit parashifet se investimi mund të bëhet vetëm në ato institucione që janë të ranguara me një rangim jashtëzakonisht të lartë që quhet 2A ose 3A, ne aso institucione në Kosovë nuk kemi, bankat komerciale nuk i plotëson ato kushte. Nuk ka ligj për letra me vlerë, pushteti i Kosovës nuk ka letra me vlerë, se po të kishte letra me vlerë atëherë Agjencioni investon në letra me vlerë dhe atëherë kur ti i nevojiten i merr ato. Ne kemi tentuar dhe kemi bërë shpesh takime edhe me ICO-në edhe më të gjithë të tjerët për me i kthyer mjetet por edhe në bazë së Pakës së Ahtisarit, edhe në bazë të ligjeve dhe të rregulloreve, është se anëtarët e Bordit nëse marrin ndonjë vendim për kthimin e mjeteve gjithësesi duhet që ta kenë një votë ndërkombëtare, por nëse ndodh tri vota kundër atëherë quhet vito dhe nuk mund të zgjidhet. Mirëpo kemi arrit që së paku me një marrëveshje me Bankën Qëndrore që prej kamatës që ka qenë dikur 0.10% të ngritet dhjetë herë më shumë dhe tashti e kemi 1.1, 1.2 % ose varet sipas afatizimit të mjeteve për ne mjetet e plasuara janë në Bankën Qëndrore. Ndërsa, Banka Qëndrore se ku i dërgon mjetet neve nuk e dimë. Lidhur me Spinofet Speciale, kanë qenë ndërmarrje të cilat janë dhënë me kushte specifike dhe ka qenë zotimi për investim dhe punësim këto e kamë bërë në kohën e AKM-së. AKP-ja nuk ka shit asnjë ndërmarrje me Spinof Special, sipas disa të dhënave ai sistem ka qenë sistem i dështuar sepse

ndërmarrjet e Spinofove Speciale janë shitur atyre njërzve të cilët kanë dashur me i'a shitë e jo atyre të cilët kanë pasur mundësi me i ble, blerësit e Spinofove Speciale nuk kanë qenë blerës serioz. Rreth Spinofove Speciale janë bërë edhe kontratat që i quajmë edhe kontrata të rrobaqepësit, pra i kanë pre thjesht janë përpunuar kontratat ashtu si ju ka marrë mendja. Penalet apo penalizimi përmes përmëshje të zotimeve të investimeve është një problem jashtëzakonisht i madh mirëpo ne me ligj e kemi që duhet që ti informojmë investitorët që janë në shkëlqje të zotimeve. Të gjitha kontratat e Spinofove dhe të komercializimit janë kontrata të ligjit anglez, bile edhe arbitrazhet edhe të gjitha duhet atëhere të shkohen në Londër apo në Angli edhe kjo është edhe një e pa drejtë e cila ju është bërë ekonomisë së Kosovës. Ne e kemi pasur një lëndë në Gjykatën Kushtetuese, lëndën e kemi fituar, ku Gjykata Kushtetuese i thotë edhe EULEX-it edhe Dhomës së Veçantë, dhe të gjithë të tjerëve se ne jemi trashëgimtar të AKM-së. Dhe tek tash në këta muaj ka filluar në Dhomën e Veçantë me na njoftë më shumë. Lidhur me Ballkanin e Suharekës, në bazë të raportimit, auditimit dhe të vlerësimeve të investimeve ata e kanë plotësuar detyrimin, është krejt diçka tjetër se çka thotë sindikata. Ndërsa Grandi, Goleshi, Strezovci, Tabacco janë të penalizuara dhe ndëshkimet arrijnë deri në 22 milion. Shoqëritë aksionare të Gjakovës janë të ndara në gjashtë grupe bëjnë dikund rreth 20 ndërmarrje, vetëm dy në Gjakovë në vitin 2006-2007-të janë njoftë siç janë Gorenja dhe Dukagjini. Transformimi i ndërmarrjeve të Gjakovës që thuhet se janë bërë në kohën e Markoviqit, kur ai ishte ne sistem në bazë të përcaktimit të statuseve që Zyra rajonale e ka bërë për ne, ato nuk janë të transformuara as pjesërisht, janë total ndërmarrje shoqërore, ku brenda natës është rritur rroga 100% dhe kanë thënë nuk po e marrim atë rrogë por po e kthejmë në aksione d.m.th është një transaksion jashtëzakonisht i dyshimtë, nuk kanë prova se janë transformuar, është stërzgjat procesi atje dhe Gjakova nuk e ka merituar këtë.

Shkelzen Lluka (Drejtor menaxhues i AKP-së) - kemi këtu një listë të cilët janë nën administrimin të drejtpërdrejt të Agjensionit, dihet se në bazë të ligjit AKP-ja administron me ndërmarrjet shoqërore kurse menaxhimet, pra menaxhimet ditore kryhet nga menaxhmenti i ndërmarrjes. Në momentin kur vëren apo kur merr informacione se ka keqpërdorime financiare në një ndërmarrje shoqërore, atëherë ndërmarrja me vendim të Bordit të AKP-së futet në administrim të drejtpërdrejt, deri sa të sanohet situata, pastaj vazhdohet me privatizimin e tyre.

Dino Asanaj (kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të privatizimit-AKP) – sa i takon shitjes dhe garancionit financiar, neve ligji nuk na jap atë të drejtë, rregullat nuk na lejojnë.

Ramiz Kelmendi – theksoj se nëse ne mendojmë që ta ndihmojmë zhvillimin ekonomik dhe meqenëse ato mjete të cilat qëndrojnë në botën e jashtme me 1.1% në Kosovë minimumin e kanë 0.9%. Neve çdo biznesi kishte me i ndihmua shumë po të ishte ndonjë proces bankar me prallongim apo me pagesë me kiste, duke e paguar 20% e punëtorëve menjëherë dhe 80 % duke e paguar kamaten bankare sa është e paraparë. Gjakova ka qenë vend i tekstilit, shumë operues tekstili janë duke punuar nëpër shtëpia ose nëpër objekte të vogla. Sikurse e kishim sjellë një formë të tipit të tillë të ligjit ne atyre njërzve të cilët kanë dëshirë të rikyqen në profesionin e kaluar.

Dino Asanaj (kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të privatizimit-AKP) – rreth pyetjes se SHARR CEM-i, në Bord një ndër anëtarët tanë është edhe kryetari i Bashkimit të Sindikatave edhe në bazë të ligjit është emëruar edhe kemi shumë raste kur punëtorët nuk e bëjnë monitorimin dhe vijnë edhe ankohen. Mirëpo, sa i përket Ballkanit të Suharekës është çështje e mbyllur, të SHARR CEM-i ka qenë dhe është një ndër ndërmarrjet e para të komercializuara, në vitin 2000, dhe është komercializuar nga drejtori në të cilën në atë kohë ka pasur drejtori në kohën e UNMIK-ut, ska qenë as shtylla e IV-te apo AKM-ja. Në atë kohë është bërë kontrata e komercializimit 10 vjeçare, në atë kontratë janë paraparë disa elemente, elementi i parë është bërë që konsesioneri në fund ka të drejtë me parablerje për blerjen e parë dhe e dyta është që ti

njihen investimet gjatë periudhës dhjetë vjeçare. Për informatën tuaj SHARR CEM-i u shit për 30 milion e 100 mijë euro dhe me obligim të investimit 35 milion euro, me mos njohje të 22 milionëve, për shkak se gjatë negociatave është bërë.

Shkelzen Lluka (Drejtor menaxhues i AKP-së) - sa i përket SHARR CEM-it në Agjencioni me vendim të Bordit ka formuar një komision në të cilën kanë qenë të pranuar edhe disa deputet të Parlamentit, që janë anëtarë të bordeve të drejtorëve, përfaqësues nga sindikata dhe dy përfaqësues nga ICO-ja të gjithë këta kanë qenë në Bord për privatizimin e kësaj ndërmarrje, si dhe eksperti i angazhuar nëpërmjet asistencës teknike të Komisionit Evropian i cili i ndihmon Agjencionit. Përpos kësaj Agjencioni e ka angazhuar edhe këshilltarin e transaksionit i cili e ka udhëhequr procesin e transaksionit gjatë tërë kohës i vetmi kusht në kontratë ka qenë çmimi.

Dino Asanaj (kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit-AKP) – Trepça është nën moratorium dhe moratoriumi është ndalesa gjyqësore e cila është bërë në vitin 2005, e cila ka qenë jashtëzakonisht mjaftë e dobishme për Trepçën për shkak se në 2005-të fillojnë edhe sulmet e kreditorëve ndaj Trepçës. Me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 hynë edhe likuidimi në këtë proces, pra Rregullorja 2005/48 i ka dy elemente, elementin e Trepçës dhe elementin e likuidimit. Në vitin e kaluar ne kemi kërkuar nga Trepça për shkak se kur është bërë moratoriumi janë futur edhe asetet të cilat nuk i kanë takuar Trepçës dhe ato janë disa ndërmarrje shoqërore të cilat edhe nga lokacioni nuk kanë qenë në Mitrovicë por të ndara nëpër Kosovë, si në Gjilan, Skenderaj, Pejë, Prizren gjithsej shtatë ndërmarrje. Dhe ne kemi kërkuar nga Oda e Veçantë që ato asete të lirohen nga moratoriumi apo nga ndalesa gjyqësore sepse më të vërtet ato nuk kanë të bëjnë asgjë me Trepçën. Ndërkohë, Oda e veçantë ka dhënë një urdhër që brenda 90 ditëve të caktojme një administrator, pra një firmë apo një person i cili do kishte me u marrë me riorganizimin dhe rivitalizimin apo edhe likuidimin. Trepça ka pesë elemente, ka elemente legal, elementin ekonomik, politik, mjedisor dhe elementin komercial. Elementi legal është element se p.sh ne kemi problem me veriun ku një pjesë e Trepçës është në veri në të cilën ne de fakto nuk kemi kontroll në të, nuk na raportojnë neve, mirëpo de juro ata marrin pare edhe atë prej buxhetit, vetëm pas lufte buxheti i ka nda rreth 100 milion euro, disa janë dhënë si grante.

Visa Ymeri – tha se për sa i përket çështjes së mjeteve dhe kthimit të tyre në Kosovë, konsideroj që si qytetar i Kosovës, ato mjete janë shumë të rëndësishme për tu kthyer në Kosovë, edhe jo në formën siç është folur deri tani për investim në banka. Sepse po e shohim se bankat nuk po e kreditojnë ekonominë e Kosovës, se nuk është e vërtetë se bankat kanë vështirësi në likuiditet, por ekonomia e Kosovës ka vështirësi me likuiditet. Kur po flitet për SpinoFin Special, në njëfarë mënyre ju po thonë që ishte dashur që të jetë Agjencioni i Privatizimit të jetë trashëgimtari i AKM-së, dhe kur je trashëgimtar duhesh ta trashëgosh edhe punën që e ka bërë rrjedhimisht SpinoFin Special ishte dashur me u monitoruar nga dikush, ky monitorim konsideroj në njërin anë se po duhet bërë përmes dokumenteve financiare, raporteve të audituara nga ndërmarrjet, por në anën tjetër për me qenë më të sigurt duke e ditur se në çfarë mjedisi ekonomik jemi duke jetuar kishte me qenë e domosdoshme që AKP-ja, ta bëjë edhe monitorimin fizik të tyre. Në rastin e Ballkanit të Suharekës, kanë vdekur dy punëtorë në vendin e punës në vende, dhe periudha të ndryshme por ka ndodh për shkak të mungesës së sigurisë dhe mendoj se ky është problem mjaftë i madh për shoqërinë e Kosovës por dikush duhet me u marrë me atë punë. Te SHARR CEM-i, transformimi i një ndërmarrje në ndërmarrje tjetër, është shumë mirë dhe shumë lehtë të bëhet kur është ndërmarrje private, por kjo ka qenë ndërmarrje komunale për vetë faktin që kanë ardhur dhe e kanë kërkuar lejen prej jush ka qenë vendim i juaj, se a do të bëhet kjo a jo. Nuk është transformim i zakonshëm, siç thatë ju, dhe thatë kur është shitë është shitë sipas çmimit të tregut, por si e keni vlerësuar ju çmimin e tregut nëse nuk ka pasur ofertues të tjerë, në bazë të çkafit ka ardh mendimi apo si e keni kalkuluar se ky është çmimi i tregut? Raporti do të duhej të ishte Raporti i punës i AKP-së, e jo vetëm Raport i sukseseve AKP-se, e veçanërisht i problemeve të cilat i ka AKP-ja, në raport me institucionet se duhet të dihet se në

fund ky Raport do ti dorëzohet Kuvendit dhe atyre deputeteve të cilët nuk kanë qenë këtu më herët.

Dino Asanaj (kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të privatizimit-AKP) – ne Raportin e bëjmë në bazë të ligjit dhe kërkesave ligjore, nëse e shikojmë në bazë të ligjit është i kompletuar.

Shkelzen Llluka (Drejtor menaxhues i AKP-së) – sa i përket SHARR CEM-it, kur është bërë kontrata e komercializimit d.m.th TITANI e ka blerë të tërë firmën, në për me u sigurua që nuk do të jemi në thyerje të çmimit të tregut e kemi angazhuar këshilltarin për transaksionit i cili e ka bërë edhe vlerësimin nga kompani ndërkombëtare.

Myzejene Selmani - pasi që e potencuat se mjete nuk po lejohen të vijnë nga jashtë sepse e kemi edhe rastin e njëjtë edhe me Trustin pensional. Mirëpo, mendoj se është më shumë si çështje politike lidhur me të gjitha likuditetet të cilat gjinden në këto asete, edhe çështja Spinofeve Speciale, ju e cekët edhe rastin e Grandit, mirëpo ju duke e pasur një kontratë e cila ka qenë në kohën e AKM-së, dhe gjithmonë duhet të flitet për ndërmarrjet të cilat kanë qenë në kohën e AKM-së, duke e ditur se juve tani ligji ua mundëson veprimtari krejtësisht të ndryshme.

Dino Asanaj (kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të privatizimit-AKP) – ne jemi të parët të cilët e kemi ngritur këtë çështje dhe them se është e pa drejtë që mjetet janë jashtë po është kërkesa e cila ekziston ende në Bankën Qendrore. ICO-ja edhe të tjerët janë përzierë dhe nuk e kanë lejuar kërkesa ende ekziston sepse nuk e kemi tërhequr ende. Sepse interesi i bankës komerciale me bizneset e sidomos me ndërmarrjet shoqërore është i pa drejtë. Mirëpo, ne nuk jemi legjislacion dhe në pa mundësi, vetëm me ngrit si çështje.

Lutfi Zharku – pyeti tek çështja e Spinofeve Speciale, nëse dikush nuk i paguan investimet çka behet me një ndërmarrje apo me një Spinof Special?

Shkelzen Llluka (Drejtor menaxhues i AKP-së) – çështja e ndërmarrjeve të shitura me Spinof Special përfaqësuesit ndërkombëtar në Bordin e AKP-së nuk dëshirojnë ta marrin një vendim të tillë, për arsye se këto kontrata që autoriteti për ekzekutimin e vendimeve të kthimit të aksioneve është Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara. Ne dy tri herë kemi dështua në procesin e angazhimit të një firme për interpretimin e këtyre kontratave për interpretimin e ligjit anglez.

Visa Ymeri - theksoj se procesi i shkëputjes së një pjese nga një shtet në një shtet tjetër është proces i dhimbshëm, dhe ai nuk bëhet pa e prerë, dhe shpallja e Pavarësisë së Kosovës ka qenë dashur të jetë një lloj prerje e tillë nga historiku dhe trashëgimia e UNMIK-ut. Po dihet që AKP-ja është e okupuar ligjërisht, pyeti se çka ka ndërmarr AKP-ja, në raport me institucionet vendore, po ashtu edhe nga Qeveria e Kosovës për me e ngritë këtë privatizim?

Dino Asanaj (kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të privatizimit-AKP) – desha të ju informoj se AKP-ja është i vetmi Agjencion i cili është i shtrirë në të gjithë territorin e Kosovës kemi zyrën në Leposaviq, Shtërpce, Graçanicë, kemi bërë shitje në veri për përmbylljen e kontratave.

Shkelzen Llluka (Drejtor menaxhues i AKP-së) – sa i përket trashëgimitarit ligjor AKP-ja me vendimin e fundit të gjykatës kushtetuese ku ka qenë për të gjithë prezencën ndërkombëtare ku ka qenë si një bumerang për ata ku ky është interpretimi i gjykatës. Ne jemi në bashkëpunim edhe me institucionet vendore edhe me zv.kryeministrin.

Pas debatit të gjerë Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit -AKP-së, për vitin 2010.

dhe Kuvendit i parashtrohet këtë:

Rekomandim

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit -AKP-së, për vitin 2010.*
- 2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, kryetari i Komisionit Zenun Pajaziti.*

4. Të ndryshme;

a) Formimi i Grupit punues për shqyrtimin e Projektligjeve;

Kryetari – propozoj që të formohet një grup punës prej pesë (5) anëtarëve të Komisionit për shqyrtimin e projektligjeve: nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim; nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare dhe nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme.

Pas diskutimeve Komisioni unanimisht nxori këtë

V E N D I M

- 1. Formohet Grupi punues për të shqyrtuar Projektligjet: nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim; nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare dhe nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme;*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Teuta Sahatqija raportuese, Sala Berisha – Shala, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Ramiz Kelmendi.*
- 3. Grupi punues ne bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e Veprimit, dhe brenda afatit prej dy muajve ti paraqet propozim-amendamentet ne Raport me shkrim Komisionit për shqyrtim dhe miratim.*

b) Mbledhja e radhës;

Kryetari – i njoftoi deputetët së mbledhja e radhës do të mbahet më datë 10.05.2011, ku do të shqyrtohet Raporti vjetor për vitin 2010 i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës - AKK-së.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit